



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1295/ 11 prot.

Datë 31.07.2026

V E N D I M

Nr. 918/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.776/2026, datë 10.06.2026, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur*”, me Nr. REF-82186-04-16-2026, me objekt “Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore”, me fond limit: 49,518,900 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Endri Dulellari” P.F, Nipt L71731025U
Adresa: Rr. Shyqyri Ishmi, Pll. 26/1. Shk. 1, Ap. 21, K. 5, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Himarë.
Adresa: Rr. “25 Marsi”, Nr.2; Spile, Himarë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me Vendimin Nr.776/2026, datë 10.06.2026 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Endri Dulellari” P.F për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur”, me Nr. REF-82186-04-16-2026, me objekt “Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore”, me fond limit: 49,518, 900 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Endri Dulellari” P.F për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur”, me Nr. REF-82186-04-16-2026, me objekt “Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore”, me fond limit: 49,518, 900 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarime përkatëse në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet me shtojcë, në Sistemin Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Endri Dulellari” P.F.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 2680/27 prot., datë 16.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1295/7 prot., datë 20.07.2026, autoriteti kontraktor informon se ka zbatuar vendimin Nr. 776/2026, datë 10.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

I.3. Me shkresën ardhur në Sistem protokolluar me Nr.1295/8 datë 28.07.2026 me objekt argumente mbi shtojcën e hartuar nga Autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik ankimues.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën ardhur me nr. 2680/27 prot., datë 16.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1295/7 prot., datë 20.07.2026, autoriteti kontraktor informon se ka zbatuar vendimin Nr.

776/2026, datë 10.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, bashëlidhur AK ka përcjellë shtojcë me modifikime të DST.

Komisioni kreu verifikime në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, dhe konstatoi se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcat për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga shqyrtimi i së cilave rezultoi, se Autoriteti publikuar Shtojcën me modifikime të kriterëve kualifikimit, dokumentin Grafik Zbatimi si edhe dokumentin Preventiv Memec.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së dokumentacionit sipërcituar mbi modifikime të DST Komisioni konstatoi se Autoriteti kontraktor ka kryer pjesërisht modifikime në tre dokumentet publikuar në SPE më datë 16.07.2026.

Konkretisht referuar Vendimit të KPP-së si edhe përmbajtjeve të shtojcave të publikuara në SPE Komisioni konstatoi se, autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur saktë modifikime në lidhje me konstatimet e KPP-së në Vendim për pikat si vijon:

Ne pikën III.5, Mbi Formularin Termat e Referencës, Dokumenti Preventiv, Detyrat që do të jenë pjesë e punës së Autoriteti Kontraktor duke përcaktuar saktë dhe në mënyrë shteruese detyrat e tij siç janë: Planin vjetor të aktiviteteve, kohëzgjatja për çdo aktivitet, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor; Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim); Përshkrimin e aktivitetit me detaje; Numrin e pjesëmarrësve; Vendi i kryerjes së shërbimeve: Gjithë territori i Bashkisë Himare, (përcaktim evaziv) etj si dhe **detyrat/punët që do të kryejë Operatori Ekonomik**, duke hartuar **specifikime teknike të hollësishme të qarta për çdo aktivitet si edhe plotësim të Termave të Referencës me të dhëna të hollësishme të plota, të qarta dhe të zgjeruara.**

III.5.6. Kriteri 2.3.6, Autoriteti e ka argumentuar kriterin dhe rëndësinë e tij por nuk ka dhënë **specifikime teknike të hollësishme dhe orientuese për mjetet e listuara në kriter.** të gjitha materialet mbështetëse për realizimin e çdo aktiviteti konkret, me një listë përkatëse me mjetet/pajisje të me specifikime /parametra, përmasat, fuqi, apo edhe ilustrime të ngjashme etj, duke përshkruar në mënyrë të saktë dhe shteruese çdo element në funksion të shërbimeve/aktiviteteve që kërkohet dhe do të realizohen nga ofertuesit si edhe detyrat e Autoritetit Kontraktor.

III.6.1. Kriteri 2.3.4 [...] për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës, të sigurohet, që operatori ekonomik, i cili do të shpallet fitues, të ketë të gjitha kapacitetet e nevojshme teknike dhe profesionale për përmbushjen me sukses të kontratës, për këtë arsye, duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke kërkuar, që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë stafin sipas kualifikimeve të nevojshëm, por pa e kufizuar mënyrën se si e disponon, me personel të punësuar si pranë subjektit ofertues apo me kontrata shërbimi për të gjithë kohën e zhvillimit të procedurës deri në përfundim të realizimit të saj.

III.7. Mbi modifikim/sqarime të kriterit **2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat.** Autoriteti Kontraktor të rishikojë kriterin 2.3.5 të japë sqarime të plota dhe shteruese lidhur me paqartësitë e ngritura në ankesë nga operatori ekonomik.

Sqarimet e detajuara janë të domosdoshme për të siguruar një kuptim të saktë të kërkesave dhe për të shmangur interpretime të ndryshme që mund të ndikojnë në përgatitjen e ofertës dhe në zhvillimin në kohë të procedurës së prokurimit por edhe për një proces vlerësimit sa më të drejtë të ofertave të operatorëve ekonomikë nga KVO.

Komisioni gjykon se shtojca me modifikimet e pasakta sjell konfuzion tek operatorët ekonomikë pjesmarrës të mundshëm në këtë procedurë prokurimi

II.2. Sa më sipër konstatuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, *Bashkia Himarë* nuk ka zbatuar plotësisht vendimin Nr. 776/2026, datë 10.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-82186-04-16-2026, me objekt “*Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore*”, me fond limit: 49,518, 900 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.
2. Autoriteti kontraktor të hartojë shtojcë me modifikimet përkatëse në përputhje të plotë me vendimin nr. 776/2026 datë 10.06.2026 të KPP-së.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu